

VENDIM
Nr. 881, datë 24.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E
NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E RIMORKIOVE
TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 7, e vendimit nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Periudha e veprimit të Task-Forcës do të jetë deri më 31 dhjetor 2020.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama